



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 06 Maj 2022

Nr: 158

V E N D I M

PËR

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË SHOYRTIMIT ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT TË ORGANIZATËS “QENDRESA QYTETARE” NDAJ Z. ARBEN AHMETAJ MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E REFORMAVE, Z. EDISON MEMOLLA KANDIDAT PËR KRYETAR BASHKIE NË BASHKINË RROGOZHINË, Z. ETJEN XHAFAJ DEPUTET I KUVENDIT TË SHQIPËRISË, SUBJEKTIT ZGJEDHOR “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE NË KUADËR TË FUSHATËS ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022”**

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 09.04.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Referuar nenit 19, pika 1 shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Data: 06 Maj 2022

Nr. 158

“Për zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj z. Arben Ahmetaj, z. Edison Memolla. Z. Etjen Xhafaj, subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”



Referuar nenit 7, të vendimit nr. 9, datë 09.04.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

- 1- Komisioneri fillon procedurën administrative dhe hetimin administrativ kryesisht me depozitimin e denoncimit në Portalin e Denoncimeve ose kur ajo mbërrin drejtpërdrejtë në KQZ.
- 2- Afati që ka KQZ-ja për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga paraqitja e tij.
- 3- Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kur çështja është komplekse ose është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë.

Lidhur me denoncimin e Organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj z. Arben Ahmetaj Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, z. Edison Memolla kandidat për kryetar bashkie në bashkinë Rrogozhinë, z. Etjen Xhafaj deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, nëpërmjet së cilit pretendohet se, *“Në datë 04.03.2022, në Rrogozhinë, kandidati i Partisë Socialiste të Shqipërisë për kryetar të bashkisë Rrogozhinë, z. Edison Memolla, i shoqëruar nga zv. Kryeministri njëkohësisht dhe Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, z. Arben Ahmetaj, me pjesëmarrjen e deputetit të zonës dhe disa banorë të zonës, inspektuan shkollën “Qamil Gjuzi” që është në proces rindërtimi.*

*Gjatë këtij takimi, siç vërehet nga provat, z. Memolla dhe z. Arben Ahmetaj, në këtë takim kanë promovuar investime vendore në atë zonë duke mbështetur dhe promovuar objekte të rindërtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore”. Gjatë këtij takimi, siç vërehet nga statusi në profilin personal në “Facebook” të z. Memolla, shprehet mbi veprimtarinë: “Inspektim me zv. Kryeministrin z. Arben Ahmetaj dhe deputetin z. Etjen Xhafaj në shkollën “Qamil Gjuzi” që është në proces rindërtimi”.*

*Ndër të tjera, në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ky takim nuk rezultoi të jetë raportuar në referim të parashikimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor.*

Veprimtaria e kryer është në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Edhe pse ka përfunduar afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “p”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3 e vendimit nr. 9, datë 09.04.2021

Data: 06 Maj 2022

Nr. 158

“Për zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj z. Arben Ahmetaj, z. Edison Memolla, Z. Etjen Xhafaj, subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjeshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”



“Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

## V E N D O S I:

1. Zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare”, ndaj ndaj z. Arben Ahmetaj Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, z. Edison Memolla kandidat për kryetar bashkie në bashkinë Rrogozhinë, z. Etjen Xhafaj deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 06 Maj 2022

Nr. 158

“Për zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj z. Arben Ahmetaj, z. Edison Memolla, Z. Etjen Xhafaj, subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”